

VENDIM
Nr. 613, datë 31.8.2016

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 17.3.2016, PËR ÇËSHTJEN “RISTA DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË” (PËR ANKIMET NR. 5207/10, 24468/10, 36228/1, 39492/10, 39495/10, 40751/10 DHE 48522/10)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr.147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 17.3.2016, për çështjen “Rista dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, për ankimet nr.24468/10 (Gjikolli dhe Molla), nr. 39492/10 (Galanxhi dhe të tjerë), nr. 39495/10 (Frashëri dhe të tjerë), nr. 40751/10 (Merlika dhe të tjerë) nr. 48522/10 (Dhimertika dhe Nika), sipas listës së ankuesve në shtojcën 1 dhe shumat e përcaktuara në shtojcën 2, bashkëlidhur këtij vendimi dhe që janë pjesë përbërëse e tij, plus çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme.

2. Në zbatim të vendimit të GJEDNJ-së, të bëhet ekzekutimi, me mjete të përshtatshme, i vendimit nr.981, datë 27 shtator 2001, i Gjykatës së Lartë, për aplikimin nr. 5207/10 (Rista), brenda 3 muajve nga data kur vendimi është bërë përfundimtar.

3. Vlerat e përcaktuara si detyrim, në pikën 1, të këtij vendimi, gjatë ekzekutimit të vendimit të konvertohen në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku është depozituar shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

4. Vlerat e përcaktuara si detyrim, në pikën 1, të këtij vendimi, të depozitohen në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesve, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi, në vlerën që shteti shqiptar detyrohet, sipas vendimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 17.3.2016, për secilën çështje.

5. Pagimi i shumave të depozituara, sipas përcaktimeve në pikën 3, të këtij vendimi, në favor të ankuesve: “Rista dhe të tjerë kundër Shqipërisë”, për ankimet nr. 24468/10 (Gjikolli dhe Molla), nr. 39492/10 (Galanxhi dhe të tjerë), nr. 39495/10 (Frashëri dhe të tjerë), nr. 40751/10 (Merlika dhe të tjerë) nr. 48522/10 (Dhimertika dhe Nika), të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm ligjor për kryerjen e pagesave, brenda një afati 3-mujor, nga dita kur vendimi i gjykatës është bërë përfundimtar.

6. Në rast mospagimi brenda afatit 3-mujor, të përmendur në pikën 5, të këtij vendimi, mbi shumat e mësipërme paguhen interesa të thjeshta, të barabarta me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind.

7. Efektet financiare, të parashikuara për ekzekutimin e këtij vendimi, të përballohen nga fondi i kontingjencës së buxhetit të shtetit.

8. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Agjencia e Trajtimit të Pronave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA 1
LISTA E APLIKUESVE PËRFITUES

Nr.	Çështja dhe numri	Emri i aplikuesve (viti i lindjes)	Vendbanimi	Përfaqësuar nga:	Data e prezantimit
1.	Rista, nr. 5207/10	Kozma Rista (1936)	Shqipëri	J. Mërtiri, avokat	12 janar 2010
2.	Gjikoili dhe Molla, nr. 24468/10	Kurtsh Gjikoili (1925), zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij Pakize Zajmi ose Gjikoili, Rajmonda Karapici ose Gjikoili, Adnan Gjikoili. Nuri Gjikoili (Xhikaj) (1930), zëvendësuar nga trashëgimtarët e tij Ganimete Xhikaj, Përparim Xhikaj, Dhurata Xhikaj, Adrian Xhikaj, Pamela Xhikaj, Velson Xhikaj. Hysnije Xhikoili (1932), zëvendësuar nga trashëgimtarët e saj; Muharrem Xhikoili (1954), Burhan Xhikoili (1957), Edmila Molla (Xhikoili) (1959) Muharrem Xhikoili (1954) Burhan Xhikoili (1957) Edmila Molla (Xhikoili) (1959)	Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Itali	S. Puto, avokat	16 prill 2010
3.	Galanxhi dhe të tjerë nr. 39492/10	Nexhip Galanxhi (1932) Ylli Galanxhi (1949) Rozalt Galanxhi (1971) Fredia Lara (1957) Florentina Galanxhi (1947) Esmeralda Trolai (1981) Lirika Asllani Lara (1946) Haxhire Zhegu Galanxhi (1938) Rexhina Lara (1981) Ariana Lara (1958) Livia Lara (1990)	Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri	S. Puto dhe A.Prifti (Memi) avokatë	9 korrik 2010
4.	Frashëri and Others, nr. 39495/10	Orhan Jegeni (1936) Kapllan Jegeni (1937) Nermin Bubani (1939) zëvendësuar nga trashëgimtarët Loredan Bubani (1939), Elvana Bubani ose Zaimi (1961),	Shqipëri Shqipëri Shqipëri	S.Putto avokat	9 korrik 2009

		Gjergj Bubani (1966), Suat Jegeni (1942) Naide Shkodra (Frashëri) (1929) Fiqirete Frashëri (1930) Hajri Frashëri (1951) Hysref Frashëri (1956) Ilona Ziso (1962)	Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri		
5.	<i>Merlika and Others</i> , nr. 40751/10	Gëzim Kaçiu (1956) Sajrie Kuta (Merlika) (1934) Lumnije Karami (Merlika) (1937) Luljeta Ndreu (Kaçiu) 1960) Liljana Kaçiu (1963) Shyqyri Merlika (1935) Kujtim Merlika (1941) Ilir Alija (Merlika) (1935) Ardjan Aliaj (1960) Hysen Kasmi (1946) Afrim Kaçiu (1958)	Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri Shqipëri	S. Dodbiba, avokat	10 qershor 2010
6.	<i>Dhimertika and Nika</i> , nr. 48522/10	Arjan Dhimertika (1961) Konde Dhimertika (1941) Engjell Dhimertika (1963) Jeta Dhimertika (1973) Evjeni Dhimertika (1938) Leonora Nika (Dhimertika) (1962) Gëzim Dhimertika (1972)	Shqipëri Greqi Greqi Shqipëri Shqipëri Gjermani	S. Puto, avokat	30 korrik 2010

SHTOJCA 2 – SHPËRBLIMI I DREJTË

No.	Aplikimi dhe numri	Dëmi Pasuror dhe dëmi jopasuror	Kostot dhe shpenzimet
1.	<i>Rista</i> , nr. 5207/10	Nuk ka pretendime (ankesat janë paraqitur jashtë afatit)	Nuk ka pretendime (ankesat janë paraqitur jashtë afatit)
2.	<i>Gjokolli dhe Molla</i> , nr. 24468/10	1.562.100 (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e njëqind) euro	850 (tetëqind e pesëdhjetë) euro
3.	<i>Galanxhi dhe të tjerë</i> nr. 39492/10	216.600 (dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind) euro	850 (tetëqind e pesëdhjetë) euro
4.	<i>Frashëri and Others</i> , nr. 39495/10	3.330.500 (tre million e treqind e tridhjetë mijë e pesëqind) euro	850 (tetëqind e pesëdhjetë) euro
5.	<i>Merlika and Others</i> , nr. 40751/10	1.171.800 (një milion e njëqind e shtatëdhjetë e një mijë e tetëqind) euro	Nuk ka pretendime (nuk është paraqitur pretendim specifik)
6.	<i>Dhimertika and Nika</i> , nr. 48522/10	4.416.900 (katër milion e katërqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e nëntëqind) euro	850 (tetëqind e pesëdhjetë) euro